

854-1

—
H 21

FASLLI
HALITI

Sot

POEZI

891.183-1

H 21

FASLLI HALITI

S

S O T

(POEZI)

~~79640~~

12625

LIBOTEKA E SHTETIT
GJERGJ KASTRIT

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

K U D O

PPSH

Me lule mbjellur në lulishte,
PPSH mbi mezhda shkruar,
Shkruar me zaje të kuqe bri rrugësh,
Shkruar me rrahe në ballin e malit,
Shkruar vitrinash mbi faqen e xhamit.

PPSH

Në hyrjen e një fabrike, uzine,
PPSH në prolog të një poeme
Dhe tani në vjershën time.

KULLIMI

Vatra të shpërndara ujlash mbi grunja.
Hapin fshatarët vija.
Rrjedhin, kullojnë ujrat,
Rinohen,
Çelen grunjat.

Puna e mbarë, vija po hapni, shokë fshatarë?
Pellgje dhe ujra ka grunjave shumë.
Ka dhe në vjershat e mia ujë,
Në ndërgjegjen time ka:
Këneta, pellgje, moçale...
Në ndërgjegjen,
Në vjershat e mia ja —
Si juve po hap edhe unë
Vija kulluese, kanale...

K A L O J

Buzë dashurive,
Bukurive,
Buzë buzëve vishnje,
Buzë syve aksioniste,
Buzë vetullave, trupave të hijshëm,
Buzë flokëve që tunden, fëshfërijnë,
Buzë plepave bleroshë,
Që pluhurin e kuq perëndimit,
Si fshesa vigane ia fshijnë,
Unë i lidhur nuk kaloj,
Siç kalonte pranë sirenave, i lidhur Odisea.
Buzë tyre shkoj i lirë,
I mbushur me ndjenja të reja.
Ato, me qindra ma bëjnë me dorë,
Aty, tek traseja.

FRYMA REVOLUCIONARE

Fryma revolucionare
Nga mendjet
Pluhurat dhe mjegullat i fshin,
Si në muajin prill,
Si në muajin maj,
Kur bije mbi grunja mjegulla e parë,
Që ndryshku kallnjët e grurit mos prekë,
Fshatarët grurin e shkundin,
Mëngjeseve shpejt me litarë.

KOKËFORTËSI MBLEDHJESH

Vjersha jote mbi mbledhjet — Majakovski —
Mbledhjet fare s'i bindi...

Njera pas tjetrës mbledhjet merrnin valle,
Mbledhjet vazhdonin si dhëmbje koke,
Mbledhjet vazhdonin si dhëmbje dhëmballe.

Si dhe pas «Letrës së hapur»,
Akoma s'e prisni ju llapën e zgjatur?...

KUADROVE QË NUK U IKET

Filloi qarkullimi i madh i gjakut.
Kuadro kudo nëpër poste ku jeni,
Që dot nuk ju iket,
Që dot nuk ju zbritet:
Gufoni,
Buçitni,
Vërshoni,
Vërshoni nër dej, në trup të Shqipërisë,
Qarkullimin e madh të gjakut vazhdoni,
Gjersa jeni gjak i Partisë!

PAS MBLEDHJES

Ty t  kritikuan
Dhe veten kritikove,
Dhe dole nga mbledhja...
Dole kok ur, i skuqur, sigurisht,
Ashtu si s pata q  del nga kova i,
Pak z e skuqur, e nxehur,
Por e kalitur, e mprehur, dyfish,
Dhe bie
mbi trungjet
e vjet r
pastaj,
Dhe trungjet e vjet r i ndan m  dysh.

LUSHNJA NATËN

Drita
Që shtohen,
Që çelin,
Si boçe pambuku
Të bardha përnatë.

Një parcelë e mbjellur
Lushnja,
Me drita, dritare,
Ballkone,
Pallate.

N A T A

Nata —

Si nënë dëshmori me sharpin e zi,
Mbi varre dëshmorësh yjet e artë,
Si tufa lulesh i hodhi që lartë.

A J O

U ndeshën sytë e saj me shikimin tim,
Si dy ajzberge u ndeshën,
U thyen.

E fyer më tha:
— Jam qytetare!
Jeni fshatar!
S'mund të martohemi bashkë!
Të kuptòva, e qartë:
Je copë dëbore në mes të beharit,
Mos u ngut —
Shkrirjen e ke të sigurt!

UNË, MËSUESI I FSHATIT

Çaj baltrat e rrugës.
Çizmet mbyten e zhyten në baltë.
Prapa, në llucë,
Mbeten gjurmët e mia,
Si mbresa të thella në trurin e rrugës,
Mbeten gjurmët e çizmeve
Të NISH-gomave-Durrës.

Eci.

Në kokë formula,
Konvencione,
Kryengritje fshatare,
Esklamacione dhe vargje poetësh
Dhe imazhi i vajzës brune,
Që prapa mbeti,
Kur mua më përçolli
Herët nga qyteti.

Futem në klasë.
Era shtyn xhamat me gjoks.
Nxënësit shikojnë çizmet e mia me baltë,
Pantallonat e mia zhytur në çizme,
Floket e mi të qullur,
Që kullojnë,
Që varen te poshtë,
Si flokët e Senekës,
Shikojnë ditarin e lagur
Dhe supet qull të xhaketës.

Dhe lodhja më ikën, më zhduket pas kësaj,
Si balta që rrugëve thahet,
Si balta që zhduket në maj...

VEÇ KUJDES

Në pranverën e jetës ne jemi?

Jeta jonë pranverë?

Po!

Dhe po me zë të fuqishëm e themi.

Veç kujdes, barishtet e këqia...

Barishtet e këqia pranverës mbijnë.

Veç kujdes... pranverës, shokë,

Pranverës, ditëve me diell,

Hijet më tepër nxijnë.

Në arën e blertë të shoqërisë socialiste

Me erbicidin e kritikës së rreptë,

Rreptë t'i spërkasim barishtet e këqia,

Me erbicidin e kritikës së rreptë

Barishtet e këqia fare t'i thajmë,

Fije për fije burokratët t'i shkulim,

Mikroborgjezët si mollër¹⁾ t'i harrim,

1) mellërë

Hijet e zeza fare t'i zhdukim,
Hijet e zeza,
Si napa të zeza,
Botës së vjetër në qafë t'ia varim.

R R U D H A T

Ballin e kisha shesh,
Ballin e kisha si djerre,
Me brazda, shikoje, u mbush si ugar,
Koha pleqérinë nisi të mbjellë.

Mbillma pleqérinë, po deshe, moj kohë,
Mbillma pleqérinë, po deshe, në ballë,
Shpirti im nuk bëhet ugar,
Shpirti im do mbetet lëndinë,
Shpirti im do mbetet vilar...

UNTEKA E SHTETIT
SUDOKASITE

48640

PANORAMĒ MYZEQARE

Bredhin dy syt' e mi
Mbi gjelbërimin e fushës pa kufi.

Cicërojnë kore harabelash,
Sikur këndoijnë kore pionierësh.

M'i madhi mik i fushës, plugu,
Mbi skenën e blertë këndon.
Një kor draprinjësh, kazmash, kombajnash
E shoqëron.

Të entuziazmuara, duartrokasin gjethet,
Duartrokasin plepat, shelgjet,
Puhirat fërshëlljinë,
Grunjat, misrat dehen,
Rrëkerat meken,
Kanaleve ujrat ndrijnë.

Vet  m pesimistja qyqe —
Ku, ku... qan,
Pesimistja qyqe vet  m vajton.

Iku qyqe ajo koh  ,
Kur m  ngjeseve vajtimi yt
Myzeqarin barkbosh e tmeronte,
Kur qyqari myzeqar,
M  ngjeseve,
Vajtimin t  nd d  gjonte.

Ata m  ngjese ik  n, qyqe,
Ik  n ato koh  .
Iku mjerimi s  bashku me to,
Thyj qaf  n, pra, qyqe,
Pusho!

K  ndoni kore kombajnash, belash,
Plug, ligj  ro,
G  zim versho!
Grunja vallzoni, shushurini,
Shtyjini ujrat kanale, k  ndoni,
Hapsira myzeqare —
Bleroni!

TI NIPÇE, KËTË NUK E DI

Ti nipçe, këtë nuk e di.
Kjo ka kohë,
Kjo nuk ka ndodhur tani.

Flokra të dendura drizash ka pasur Myzeqeja,
Flokra ferrash kjo fushë ka pasë,
Si flokët e tua, nipçe, kaçurrela,
Si flokët e tua të shpeshta pa masë.

Veç, kooperativa berbere e rreptë
Flokrat e ferrave fare ia qethi
Në diell —
Morri i pronës së vogël ngeli
Dhe ngordhi, o nipçe, pëlciti nga dielli.

Ç'KAM PARË NË FËMIJËRI

Kalbte trarët kalbësira,
Hante, brente qeprat mola,
Nëpër sjetulla qoshesh — blozë,
Nëpër qepra të trasha, të holla,
Ndërtonte folera brumbulli,
Flaka e kandilit lulëzonte e verdhë,
Si një lule kungulli.

Në gardh të kasolles,
Me hijen e gjishtrinjve,
Na bënte ca lepuj në mbrëmje babai,
Çfaqje na jepte neve fëmijve.
Kënaqesha duke parë këtë film primitiv,
Kënaqesha duke parë këtë çfaqje primitive.

Fëmini,
Fëmini,
Sa gjëra, sa gjëra...
Më ke fshehur ti!

KISH UJË NË SHPATULL MYZEQEJA

Mijra vjet Myzeqeja,
Mijra vjet Tërbuin e shkretë,
Si ujë në shpatull e mbante;
Kush t'ia gjente diagnozën asaj,
Kush ujin në shpatull t'ja thante?

Vetë qeveritë qenë të ndërtuara,
Që shpirtin e mbanin me gjëra të sëmura.

Diagnozën
Partia sa erdhi diktoi.
«Ujë në shpatull»
Recetën lëshoi.

Vret misri sot kokën në kupën e qiellit,
Gruri kërcen nën dritën e diellit,
Me të lehtën,
Të shkathtën,
Të butën puh,
Aty ku dije këneta
Qelbej me ujrat e verdha zhabi.

NË FUSHË

Nuk prashitet më,
Nuk korret më.
Vapë
Sa s'ka.

Dielli në kupën e qiellit si çangë
Me trokitje rrezesh vapën lajmëron.
Ngulur mes misrit në dhe
Kazmën le,
Le draprin mes grurit mbi duaj,
Balli djersë,
Kanotjeria ujë.

Gorrica,
Si çadër e kaltër mes fushës, gorrica.
Hedh shpatullave çarçafin blu të hijes së saj.
Si mbi një kolltuk të butë special,
Ulem mbi poplën e plisit pastaj.
Shuhen mushkritë e djegura me ajër.

Kamerjerja puhi
Servir freski.

Gjoksi gjithë djersë,
Gjoksi im i nxehur,
Gjoksin kotruves ia than.
Gjethet tunden, ftohin ajrin,
Ma djegin më shpejt cigarin.

Kazma çlodhet e ngulur në dhe.
Unë i mbuluar me çarçafin blu të hijes,
Bije, fle.

KTHIMI I SKËNDERBEUT NË KRUIJË

Ra perëndimi
me hënë e re
Si flamur otoman,
Kur Skënderbeu rrufe
Mbi dherat e tia u çfaq.

U ndezën yjet e shuar
Në qielin e zi shqipëtar
Dhe Krujës i mbinë në gjoks
Si qindra dhe mijë lulkuqe,
Qindra dhe mijë pishtarë.

Pastaj një mëngjes i qashtër agoi,
U ngrit një shqiponjë nga shkrepat,
Pezull mbi qielin e purpurt qëndroi.

Ishte mëngjesi i parë,
Si flamur i kuq shqiptar.

PRANVERË

I dogji dielli retë si kaçube.
Ngecin balona tabake ndër tela.
Me gérshérën e bishtin dallandyshja
Shiritin e inaugurimit të pranverës e preu.
Një kumbull të lulzuar pemishtet
Pranverës i dhanë buqetë.
Mbi stola lulishtesh u ulën pensionistët,
U ngjiz,
U vak dheu,
Kopsat e këmishës rinia zbërtheu.

S O T

Agjenci,

Njerëz.

Njerëz që venë në kampin e Lurës,

Që venë të takojnë të fejuarën,

Që nisen të shohin një ndeshje futbolli,

Që nisen të marrin provimin e parë,

Që nisen të marrin provimin e fundit,

Njerëz që nisen kufirit ushtarë.

Njerëz që ikin kudo,

Ku të mund,

Rrugë,

Njerëz,

Qëllime pa fund...

KTHIMI I PUNTORËVE

Skuq qielли i perëndimit
Si sfond i tendosur tribune.
Gjysëm dielli edhe rrezet
Fiksohen në sfondin e kuq.
Parakalojnë brigadat puntore pas pune.

Parakalojnë brigadat puntore
Përpara kësaj tribune përnatë,
Shikoj çdo mbrëmje këtu
Një grafikë,
Një pllakatë...

R R U G A

Para meje rrugët si teza provimi:
Xhade,
Monopate,
Bulevarde.
Jam përpara provimit të jetës.
Kë të marr e kë të zgjedh?!.
Atë që këmbën ta mban të pastër,
A tjetrën që baltrash të zhyt e të kredh?!.

Vehtes i them i vendosur:
«Merr pa frikë monopatin,
Ky, vërtet të lodh nëpër male,
Porse të ngjit e të ngre,
Ky të nxjerr në rrugë të madhe!

K O L E G U

Nata,
Bulevardi,
Fshesari dhe unë.
Eja fshesar,
Jemi kolegë —
Ndize një cigar!

Mëngjezeve, ti, me natë,
Plehra fshin me fshesë në bulevard.

Fshij plehra dhe unë me këngën time.
Plehra shekullore
Në ndërgjegje shtruar qilim,
Fshij me vjershën time,
Fshij me vargun tim.

Jemi kolegë, shoku fshesar,
Merre —
Ndize një cigar!

A G R O N O M I

Shokut tim agronom A.XH.

Prill,

Baltra,

Shira.

Zbath këpucët e reja,

Var prapa derës rrrobat e mira.

Mushama meshine vesh,

Ve në kokë kasketë,

Çizme vendi mbath,

Fushave, arave zbret,

Mëngjezi akoma pa zbardhur

Dhe ecën mbi barin, mbi tokën e ardhur.

Pérpara, ja, dualën parcelat,

Ti po afrohesh, po mbrrin,

Grunjat tē presin me gazin jeshil,

Në thirrje shushurimash pastaj shpërthejnë,

Kur duke ardhur ty tē vërejnë.

PORTRËT SHQIPTARI

Si dy harqe urash dy vetullat.
Tre rrugë rrudhash të thella mbi ballë.
Mbi rrugën e rrudhave ecin të tria:
Besnikria,
Krenaria,
Trimëria.

RINI E RE

Malet shkëmb shkallzon kudo.
Në to nuk ngjiten legjione, ushtri,
Legjione drithrash do ngjiten në to,
Buka, pra, do ngjitet në të tilla lartësi.

Cilët breza bukën e ngritën kaq lart,
Cilët breza bukën e vlerësuan kaq?

Malet bënin luftën zakonisht,
Po nesër nevoja po qe,
Në malet do bëhet dhe lufta,
Do bëhet dhe buka atje!

KUR VININ PRANVERAT...

Kur në fushë pranvera vinte,
Varte lëkurën gjarpëri në ferrë.
Në gjoksin anemik
Pranverat i vinin fushës flutura,
Muzeqarit në gjoks i vinin hoxhallarët nuska.

Nga që fushës i mungonte uji pranverës, verës,
I ngordhnin në gjoks fushës fluturat,
Nga që myzeqarit i mungonte buka,
Hante myzeqari
Dyllin nuskave.
Si myzeqarkat që linin pajën përgjysëm e vdisnin,
Në Myzeqe pranverat vinin;
Nga malarja mbi ujrat e Tërbufit të sëmura binin,
Përgjysëm pranverat
Linin
Blerimin.
Mbeteshin pranverat pa bleruar,
Si myzeqarkat, që vdisnin pa u martuar...
Si kalamanjtë, që vdisnin pa u burrëuar

S H I M A J I

Shiu bije, shushurin,
Si një e çarë shalqinit,
Vetëtima, vetëtin.

Të trullos grahma e tokës së lagur,
Shkrihet i kënaqur, thërmohet plisi,
Çarton patatja, bichelja, pambuku,
Nuk përbahet gruri, misri,
S'e përmban buzëqeshjen bujku.

Shiu bije, shushurin.
Bulon buzqeshja nëpër bujqër,
Bulon buzqeshja nëpër bimë.

ARDHJA E VJESHTËS

Mbi koka jeshile pemësh
Natyra derdhi bojë të verdhë,
Vjeshta krahët e artë
Mbi fusha i hodhi
Dhe kodrave lart.

Fytyrën pa vjeshta mbi pellgjet me ujë,
Flokrat bionde pakrehur, rrëmuajë.
Shirat ardhjen e sajë
E shpallën me gaz e me bujë.

Qielli si lodër vigane gjëmoi,
Krisën si pushkë rrufetë,
Si pushkë gazmore në ditën e dasmës,
Në pritje të nuses që zbret.

MARTON VJESHTA VAJZAT

Marton vjeshta vajzat,
Marton vjeshta djemtë,
Daulleve të bubullimave qiejt
Me shkopinj vetëtimash u bien.

Degët e vidhave belin e dredhin,
Fushave valle erërat seç hedhin.

Dridhuni degë,
Dridhuni lladike!
Nën ritme bubullimash kërceni degë,
Kërceni nën ritme sqotash lirike.

T'u trashëgofshin, vjeshtë, vajzat,
Vajzat, nuset, djemtë!
Rend moj lumturi fushave,
Rend moj dashuri, rend.

UNE NUHAS PRANVERËN

Nyja, nyjen thërret.
Me rrezet paralele zgjaten kërcellët,
Blerimi hap syrin e gjelbër gjithë qejf,
Ujrat pranverore buzqeshin të qeta,
Pemishteve pjeshka fustanin e purpur
Nis zbukuron me lulet e veta.

Nyja, nyjen thërret,
Zgjaten kërcellët,
Rrinë përpjetë...

MIK NË FSHAT

Mik me nusen vajta në fshat,
Që nusen time të gjithë të shikonin,
Dualën gocat, plakat, gratë.

«Kjo qenka, moj, nusja e nipit Shahinit?!
Ç'qenka, moj qyqe, kjo nuse kështu?!
Kjo të shikoka në kokrrën e syrit,
Supet përjashta, fustanin në gju?!»

Po daja fshatarëve nuk la pa u thënë:
— Nusen me nipin sonte kam miq!
Po dreqi ta hajë karamele s'më ndodhen,
U turpërova që dreqi ta hajë,
Nisu, or çun, edhe shko në dyqan!
Ç'dajë, ore, qenkam,
Më thoni dhe dajë...

Po dajës, fshatarët i folën të gjithë:
— Nxirru përpara kaçilen me rrush,
Nxirru përpara kaçilen me fiq!

Daja fshatarëve nuk la pa u thënë:
— Nusen me nipin sonte kam miq,
Po dreqi ta hajë, se sot bukë gruri
Plaka ime nuk paska gatuar!
Po jemi në kohën e lëmit, moj plakë,

Kur thasët e grurit tërbojnë në lëmë,
Pse t'u japim bukë misri të hanë?
Ç'dajë dreqi, ahere më paskan,
Ç'dajë dreqi, ahere më kanë!?

Po dajës fshatarët i folën të gjithë:
— Po hë, o Shahin, se buka e misrit,
Po buka e misrit ata i ka rritë,
Pse neve, çfarë jemi që bukën e misrit
Si bukën e grurit e hamë e na ngjit?! (¹)

Pra, verju bukë misri përpara të hanë
Dhe preju pas buke një kokërr shalqi
Dhe preju pas buke një kokërr bostan.

1) Na ngjit = na shijon.

Daja fshatarëve nuk la pa u thënë:

— Nusen me nipin sonte kam miq,
Po, dreqi ta hajë, krevate nuk kam,
Kam mbetur prapa, shokë, e kuptoj,
Krevati si buka qenka njësoj.

Po dajës fshatarët i folën të gjithë:

— Shtroju përtokë dyshekun në qoshe,
Hidhu përsipër jorganin e larë,
Fle nusja, fle nipi,
Flenë, ata, flenë,
Nuk janë agallarë...

Mik me nusen unë vajta në fshat,

Po nusen time kur shohin tani,

Duke korrur e duke prashitur,

Mbeten plakat, dhe gocat, dhe gratë,

Mbeten dhe burrat krejt të habitur.

I K E

Në livadhin e blerët të shpirtit të ri
Me lule ndjenjash, dashuri të njomë,

Ishe.

Por ike,

Ike shkretëtirës së shpirtit të tij,
Ku lulëzonte vetëm një diplomë...

MARSI NË SERENADE

Marsi —

Me kokën e kaltër,
Me trupin e gjelbër,
Kitarën e ujrale vari në qafë,
Si tela kitare rrëkerat i dredh,
Luleve, blerimit, iu bën serenadë.

Si vajzat që kokat nxjerrin dritaresh,
Kur natën dëgjojnë të bjerë një fyell,
Lulet kokat nxjerrin nga dheu,
Serenadën e blertë të marsit dëgjojnë,
Thithin si tinguit, veriun e vakët,
Me mijra nga toka bulojnë.

KUJTIMI IM NGA NJË EKSKURSION

Niset...
Dyqind
Kilometra rrufiti —
Ndalet autobuzi, shëmon.

Përpara
Kalaja, liqeni, Shkodra.
Buna si grua kabahe
Me bluzën e brutztë,
Trupin duke dredhur,
Futet në gjirin e detit,
Bri bregut liqeni mërmëron.
Shkodra!
Kalaja plagët akoma mjekon.

Rrugët
E Shkodrës.
Këtu ka ecur Migjeni.
Gjurmët e Migjenit
Si fosile fiksuar mbi rruge.

Ja ku ka ecur Migjeni!

Ja si ka ecur Migjeni!

Prapa,

Bjeri, prapa!

Shikoja ku këmbët i shkojnë,

Shikoja ku këmbët i ndalin! —

Migjeni ka shkelur kudo.

Këmbët i ndalin,

Në majën

E malit!

Sa shumë

Ka ecur Migjeni!

Sa mirë ka ecur Migjeni!

Shkodër!

Rrugët e tua pështilli si rul.

Dërgoja muzeut «Migjeni»,

Në rrugët e tua të incizuara,

T'i shohin brezat gjurmat e viganit.

Brodha,

Me gjurmët e Migjenit,

Brodha nëpër rrugë, —

Ja ktheva programin ekskursionit.

Shokët,

Kur të vetëm më shikonin,

Që bridhja serioz, vizitoja rrugët,
Rrugët, vetëm rrugët,
Më quanin pa shije njeri.
Dhe thoshin, pse rrugëve bëja vizita,
Kur në Shkodër kishte
Muzera dhe fabrika.

Shokët,
Me shokët
Poza bënин në sfonde antikash,
Poza bënин përpara liqenit, bri Bunës,
Kurse për vehte unë,
Përpara teatrit «Migjeni»,
Poza bëra me Migjenin. —
Poza me Migjenin
Bust.

Kthimi.
Gota,
Shporta,
Servise,
Sapuna «Venus» —
Merr kujtime nga Shkodra, dikush.
Dy gjurma mora,
Shkula nga rruga, —
Dy gjurma të Migjenit mora kujtim.

Në borsetën time kujtimi më i mirë!

SHIJE TË REJA

Retë lëshojnë shiun mbi tokë,
Zbardhon si vijë e bardhë horizonti,
Zverdhin zhabinat e verdha,
Më kërkuat fusha?
Ara, fshatra —
Erdha.

Zbresin,
Rrokullisen ujrat rrëpirash,
«Delikatesa» zhytet në baltë,
Shijojnë shpatullat shije shirash,
Shijon balli shije sqotash prapë.
Po vij në fushë,
Po kthehem në fshat.

DHURIM GJAKU

Desha të bëja dhuratë,
Të bëja dhurat' një buqetë,
Nevojë më tepër ti kishe pér gjak,
Të sjell, pra, gjak shqiptari,
Gjak shqiptari, të nxeh të.

Mbushe shiringën, doktor!
Vietnamit kët gjak ia dhuroj.
Ky është gjak i kuq shqiptari,
S'ësht' i bardhë e i zbehtë,
Ky e ngre në këmbë të rënин.
Gjaku im, Vietnam,
Është i një grupi me tëndin.

Shqiptarët gjakun e tyre,
Një grupi me tëndin e kanë,
O lulkuqi i botës —
Vietnam.

LULZIMI DHE NE

Ne jemi si pemët,
Si pemët që s'çelin njëherësh,
Megjithse pranvera për to
Vjen për të gjitha njëherësh
Të gjitha njëherësh i ngroh.

Do të lulëzojmë të gjithë njëherësh
Veç rrënjet t'i kallim në tokën e ëmbël
Dhe rrezet
kaltërsinë, blerimin pranverës
T'ja thithim me etje, o njerës.

Z H U R M È

Para meje në rrugë,
Motoçikleta kaloi plot zhurmë.
Dhe humbi mes kamionash, tutje, në muzg.
Ca krisma skapamentosh plot gas,
Si brazhem reaktivi la pas.

E pashë:

E thashë:

E gjërat e vogla sa zhurmë që bëjnë . . .

BISEDË ME BABANË

Fare s'paska pasur dashuri në ditët tona?
Përgjigju bir këtu!
Nga dashuritë tona
A nuk lindët ju?

Ka pasë në ditët tuaja
Baba dhe dashuri,
Pakëz dashuri
Dhe shumë tregëti.

Si kumbulla jeshile që vilen në prill
Dhe shiten ashtu të pabëra në treg,
Këputeshin zemrat në kohërat tuaja
Dhe bliheshin zemrat e vajzave tona,
Siç blihen në treg
Kumbullat e njoma.

TRE HERONJVE

A. Reka, M. Shehu, M. Kepi

Dhe ujit
Dhe zjarrit
Përpara s'u dilet — thosh fjala e urtë:
Por ju të tre ua dolët,
Dhe ujin dhe zjarrin i bëtë me turp.

J U D H E N E

Ju kishit ara,
Kishit çifliqe,
Kulla,
Pallate,
Pare.

Ne kishim ara — arnat,
Kishim pare — arnat në shallvare;
Por përpara ne kishim atë,
Përpara ne kishim të ardhmen e madhe,
Të ardhmen e madhe që ju nuk e kishit,
Se ju atë e shitët me pare.

Në cohën e kohës suaj të vjetruar
Ju arnoni kujtimin e coptuar.
Si endset e reja qëndisim ne sot
Në copën e kuqe të kohës, aksionet,
Malet i mbushim me valle taracash,
Si mbushnit ju me ballo sallonet.

AI LULËZON

I. BRUÇAJ

Edhe mes dimrit e dhjetorit po të jetë
Kur fryn fryma e ngrohtë e partisë
Bulojnë dhe çelin të gjithë:
Rrapi i pleqve,
Lisi i burrave,
Por e para çel
Qershia e rinisë.

Në qershinë e rinisë
Ismeti s'u shkund prej erës
Ismeti s'ra si petale,
Por çeli mes borës,
Çeli mes stuhisë
Dhe lulzon atje në male.

DUHEJ TË KËNDOJA I PARI, E DI

E kam hekurudhën te dera e shtëpisë
Duhej të këndoja i pari, e di.

Nuk këndova,
Isha i mpirë, i hutuar,
Isha si dhëndri në dasmën e tij
Si dhëndri që pret e përcjell,
Ndërsa të tjerët këndoja, kërcejnë,
Ndërsa ai në qoshe i lumtur rri.

Duhej të këndoja i pari, e di.

VAHU I DEJËS

Ndoshta i ndjekur prej mblesërish me vrap
Kaloj këtu malësorja Deje një ditë
Dhe mbeti vahu...
Vah pér udhëtarin
Vah pér dhentë e dhitë.
Këtu fshatrat kalojnë dhe hidhen matanë
Dhe prapë do kalojnë udhëtarët këtu,
Veç ujrat e Drinit më s'do kalojnë,
Por ballin ujor do përplasin në digë
Dhe nga sytë e kaltërta të ujrave nevrike
Do dalin xixa...
Jo xixa
Por llamba elektrike!

KONTROLLI PUNËTOR

Shikoi punëtorët në mbledhje!

Flasin.

Frym sipër mbledhjes erë e kontrollit punëtor.

Salla, det i dallgëzuar.

Varka e krisur e këtij shefi të çajë, ka zor.

Çohet shefi si perëndesha Tetis,

Detin

e mbledhjes

të qetësojë,

i shqetësuar,

Që me varkën e krisur të tij

Të lundrojë mbi detin e shtruar.

Por spirancat e fjalëve të tij

S'takojnë në fundin e detit të mbledhjes,

Ky det mbledhje është i thellë

Është më i dallgëzuari det,

Nuk mundet mbi të të lundrojë

Varka e shefit,

E krisur,

Me difekt.

PASQYRA E LËNDËS

Kudo	3
Kullimi	4
Kaloj	5
Fryma revolucionare	6
Kokëfortësi mbledhjesh	7
Kuadrove që nuk u iket	8
Pas mbledhjes	9
Lushnja natën	10
Nata	11
Ajo	12
Unë, mësuesi i fshatit	13
Veç kujdes	15
Rrudhat	17
Panoramë myzeqare	18
Ti nipçe këtë nuk e di	20
Ç'kam parë në fëmijëri	21
Kish ujë në shpatull Myzeqeja	22
Në fushë	23
Kthimi i Skënderbeut në Krujë	25
Pranverë	26
Sot	27
Kthimi i puntorëve	28
Ruga	29
Kolegu	30
Agronomi	31

Portret shqiptari	32
Rini e re	33
Kur vinin pranverat	34
Shi maji	35
Ardhja e vjeshtës	36
Marton vjeshta vajzat	37
Unë nuhas pranverën	38
Mik në fshat	39
Ike	42
Marsi në serenadë	43
Kujtimi im nga një ekskursion	44
Shije të reja	47
Dhurim gjaku	48
Lulzimi dhe ne	49
Zhurmë	50
Bisedë me babanë	51
Tre heronjve	52
Ju dhe ne	53
Ai lulëzon	54
Duhej të këndoja i pari, e di	55
Vahu i Dejës	56
Kontrolli punëtor	57

LIBOTEKA E SHËTËRIT
SHPALLI 1911

49640

Tirazhii 3000 kopje Format 70x100/32 Stash 2204-65

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNDORI» — Tiranë, 1969